

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KËSHILI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI**

**Tiranë, 22.02.2019**

**NJOFTIM PËR MEDIAN**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), me pjesëmarrjen e anëtarëve të tij dhe anëtarëve zëvendësues, të Avokatit të Popullit, të përfaqësuesve nga subjektet e ftuara sipas pikës 2 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të ekspertëve të EURALIUS, si institucion i ftuar që mbështet me asistencën e tij ligjore përgatitjen dhe miratimin e projektakteve rregullatorë të KED, ditën e sotme 22.02.2019, zhvilloi mbledhjen e radhës, ku në rendin e ditës ishte përcaktuar, diskutimi në parim i Projektvendimit mbi procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion.

Këshilli, i angazhuar maksimalisht për të përmbushur detyrimet e tij kushtetuese, në përfundim të diskutimeve në parim mbi këtë projektvendim, vendosi datën e mbledhjes së radhës për t'u zhvilluar ditën e premte, 01.03.2019 ora 13.00. Në këtë mbledhje do të nisë menjëherë diskutimi nën parim dhe miratimi i Projekt Akteve Normative mbi përcaktimin e procedurave të verifikimit të kandidatëve për në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.